



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 562 / Prot.
13

Tiranë, më 12/5/2017

REKOMANDIM

Nr. 11, datë 12/5/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "*Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sha)*".

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 83, datë 24.03.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sha)*", me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesve e ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në kuadër të përpunimit të të dhënave gjatë implementimit të projektit "Për identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren".

Hetimi pranë këtij kontrolluesi u iniciua nga Zyra e Komisionerit bazuar në indiciet/ankesat e ardhura nga qytetarë të ndryshëm, publikimet në median audio-vizive dhe atë të shkruar si dhe interesin publik që paraqet mbrojtja e të dhënave personale që përpunohen në kuadër të implementimit të projektit të përbashkët të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike "Për identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren".

Kontrolluesi "*Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sha)*" përpunon të dhëna personale të subjekteve të të dhënave "Klientë të OSHEE", në zbatim të projektit "Përditësimi i të Dhënave" si pjesë e rëndësishme dhe e nevojshme për realizimin e implementimit të sistemit të faturim/arkëtimit.

Paralelisht, Ministria e Punëve të Brendshme, në përmbushje të objektivave të saj ka vendosur të zbatojë një projekt për identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas (derë më derë) në terren, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Kontrolluesi "*OSHEE sha*" është ngarkuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 207, datë 16.3.2016 "Për ngarkimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (*OSHEE sha*) si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për llogari të vet dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme" për zbatimin e dy projekteve të sipërcituara.

Zyra e Komisionerit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kontrolluesin "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sha), ka konstatuar se, në zbatim të nenit 31/1/a të ligjit, kontrolluesi i është drejtuar për mendim Zyrës së Komisionerit më shkresën nr. 17225 prot, dt 17.09.2015 duke parashtruar nevojën e përditësimit të të dhënave që përpunon në zbatimin e projektit të saj.

Zyra e Komisionerit ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 875/1 prot, datë 08/10/2015 *dhënie mendimi lidhur me implementimin e projektit paraprak të OSHEE*, duke i bërë me dije që kontrolluesi të tregojë kujdes në përcaktimin e qartë të qëllimit për çdo rubrikë të dhënash (referuar formularit të deklarimit të klientit), për informimin e plotë të klientit se përse po jepen të dhënat personale. Qëllimi duhet të përputhet me të gjithë kategoritë e të dhënave që synohen të mbliidhen. Të dhënat duhet të ishin të mjaftueshme, të lidheshin me qëllimin e përpunimit dhe të mos të tejkalonin atë referuar nenit 5, pika 1, shkronjat b) dhe c) të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

OSHEE në cilësinë e kontrolluesit duhet të garantonte të drejtën e aksesit dhe të gjithë të drejtat e tjera të subjekteve të të dhënave parashikuar në nenet 12-17 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar dhe të informonte klientët, në një rubrikë të veçantë të Formularit, në lidhje me këto të drejta.

1. Gjatë hetimit administrativ u konstatua se, kontrolluesi ka deleguar përpunimin e të dhënave te përpunuesi "*Bashkimi i Operatorëve CSI Piemonte-Consorzio për il sistema informativo, Datech sh.p.k dhe Çelësi sh.p.k (BO)*". Në zbatim të projektit "*Përditësimi i të Dhënave*" kontrolluesi OSHEE është informuar nga përpunuesit (BO) që të dhënat do të përpunoheshin (mbliidheshin) nëpërmjet aplikacionit GoAdresari në tabletët e intervistuesve por edhe nëpërmjet formularëve fizik të cilët në këtë rast do të shërbenin edhe për të informuar subjektet e të dhënave në lidhje me këtë proces.

Baza e të dhënave ruhet në ambientet e përpunuesit (BO-së) dhe ndërkohë është vënë në dispozicion të kontrolluesit "OSHEE" sh.a (si dhe të përfituesit tjetër Ministria e Punëve të Brendshme) një link me kredenciale me qëllim që ata të kenë akses të drejtpërdrejtë vetëm tek të dhënat e punëve të realizuara. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga sistemi i krijuar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, në përfundim të këtij projekti, do të ruhen në një databazë të veçantë, të pavarur nga sistemet e tjera dhe pas verifikimeve përkatëse dhe kontroleve të cilësisë, çdo e dhënë e mbledhur do të transferohet në sistemet përkatëse të OSHEE-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. E gjithë mënyra e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave (fizike dhe elektronike) është miratuar nga kontrolluesi.

Grupi i kontrollit administroi si prova materiale, printime të ndërfaqes së sistemit elektronik me qëllim identifikimin e kategorive të të dhënave të klientëve si dhe proceseve të këtij përpunimi. Kategoritë e të dhënave të subjekteve të të dhënave janë:

Të dhënat për subjektin:

- Familje / Individ / Biznes (NIPT) / Institucion
- NID - nr. i kartës së identitetit (*I skanuar përmes aplikacionit*)
- Emri, Atësia, Mbiemri
- Foto e kartës së identitetit

Statusi i personit

- Ndihmë ekonomike, Pensionist, Paraplegjik-Tetraplegjik, Paaftësi totale për punë, Punonjës i administratës publike, Punonjës i OSHEE

- I larguar / Arsyeja e largimit: Emigrim, Student jashtë vendit, Student në qytet tjetër në Shqipëri, Shtëpi më vete në Shqipëri, Ndarë nga jeta.
- I huaj / Shteti (Vendi): Itali, Greqi, Angli

Të dhëna për pronën:

- Në pronësi/ Me qera / Në përdorim
- Gjendja e pronës: E regjistruar / Në legalizim/ Kontratë sipërmarrje / Kontratë Shit-Blerje
- Qëllimi përdorimit: Për banim, Shtëpi e dytë, Për zhvillim aktivitet, Për Nipt sekondar
- Sipërfaqja e pronës: ____ m²
- Viti i ndërtimit (i deklaruar):
- Foto e dokumentit të pronësisë

Të dhënat e pronarit:

- Individ/ Biznes/ Institucion
- NID (nr. i kartës së identitetit), Foto e kartës së identitetit, Emri, Atësia, Mbiemri

OSHEE

- Gjendja e kontratës, Nr. i klientit,
- Individ/ Biznes/ Institucion
- NID (nr. i kartës së identitetit), Foto e kartës së identitetit, Emri, Atësia, Mbiemri

Ujësjetës Kanalizime

- Nr. kontratës
- Individ/ Biznes/ Institucion
- NID (nr. i kartës së identitetit), Foto e kartës së identitetit, Emri, Atësia, Mbiemri

Nga të dhënat e mësipërme kontrolluesi “Ministria e Punëve të Brendshme” për zbatimin e projektit të saj ka kërkuar të përpunohen të dhënat personale:

Numrin personal, emër, atësi, mbiemër, statusin e subjektit të të dhënave “Emigrant”, marrëdhënia e subjektit të të dhënave me objektin në pronësi, me qira, në përdorim, qëllimin e përdorimit të objektit.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 9887, dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, akteve nënligjore si dhe mendimit të Zyrës së Komisionerit lidhur me implementimin e projektit rezultoi se, kontrolluesi “OSHEE” sh.a gjatë procesit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, nuk kishte përfshirë në formularin e adresarit informimin e plotë të klientit se përse po jepën të dhënat personale, qëllimin të lidhur me bazën ligjore, mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që subjektet e të dhënave gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë, sipas parashikimit në nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

2. Gjatë hetimit administrativ në kontrolluesin “OSHEE” sh.a , është konstatuar se, kontrolluesi nuk kishte hartuar një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” (e detyrueshme edhe për implementimin e këtij projekti), në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj, sipas parashikimit në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i rregullores është mjaft i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektsh të të dhënave).

3. Grupi hetimit administrativ konstatoi se kontrolluesi "OSHEE" sh.a ka përpunuar të dhënat për pronën "Foto e dokumentit të pronësisë" për klientët familjarë, të dhënat për nuklin familjar dhe të dhënat për shërbimet e Ujësjetës-Kanalizimeve, të cilat rezultojnë se janë të panevojshme për projektin "Përditësimi i të Dhënave" pa ndonjë qëllim specifik dhe të përcaktuar qartë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se sasia e të dhënave të cilat mblidhen nga kontrolluesi në kuadër të përditësimit të të dhënave me qëllim final faturimin dhe arkëtimin, tejkalon parimin për mbrojtjen e të dhënave personale sanksionuar në nenin 5 pika 1/c e Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. *Mbrojtja e të dhënave bazohet në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.*

4. Në kuadër të zbatimit të detyrimit për njoftim, nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, u konstatua se kontrolluesi "OSHEE" sh.a. ka përmbushur detyrimin për njoftim, por nuk është përditësuar ndryshimi i gjendjes së njoftimit në kuadër të implementimit të këtij projekti të ri.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për të përditësuar njoftimin nëpërmjet "Formularit të Njoftimit" është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datën 18/04/2017 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Përfaqësuesit e kontrolluesit gjatë seancës dëgjimore kanë depozituar prapësime në lidhje me konstatimet në procesverbalin e hetimit administrativ, ku pretendojnë se:

1. Me shkresën Nr. 17225 datë 17/09/2015, OSHEE i është drejtuar Komisionerit për mendim, duke parashtruar nevojën e përditësimit dhe të dhënat që kërkohen duke bashkangjitur formularët përkatës. Komisioneri më shkresën 875/1 datë 08/10/2015 ka kthyer përgjigje duke kërkuar saktësimin e përdorimit të secilës nga rubrikat dhe qëllimi i grumbullimit të përputhet me qëllimin e përpunimit, ndërkaq sugjeron që në rast së ky informacion do të përdoret nga palë të treta shpërndarja të realizohet kundrejt akteve ligjore dhe/ose marrëveshjeve midis palëve. OSHEE në dokumentacionin e përfshirë në tenderimin e Shërbimit të Përditësimit ka saktësuar qëllimin e përpunimit të të dhënave të kërkuara

Në parim, përmes procesit të përditësimit të të dhënave, OSHEE synon:

- Evidentimin e saktë të të dhënave të klientit, si dhe të objektit që furnizohet me energji elektrike dhe shmangia e rasteve të paqarta dhe konfuze, për shkak të pasaktësisë së këtyre të dhënave;

- Plotësimin e të dhënave të kërkuara sipas këtij formulari, me qëllim përmbushjen e detyrimit kontraktor, referuar kushteve të Kontratave Standarte të Furnizimit me Energji Elektrike, për klientët familjare e jo familjare, të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike, sipas Vendimeve Nr. 108 dhe 109, datë 21.10.2011 të ERE-s.

Qëllimi i identifikimit të klientit lidhet me:

- Nevojën për informacion përsa i takon marrëdhënies juridike midis palëve –Kontrata - sipas përcaktimeve të kodit Civil në pikat vijuese të tij;
- Nevoja për arkëtimin e detyrimeve, njoftim, ndërprerje arkëtim i detyruar, bazuar në kontratën e furnizimit dhe kërkesat për realizimin e procedurave të njoftimit dhe arkëtimin.

2. Masat e marra nga OSHEE në kuadër të Nenit 18, të ligjit, nga ana e OSHEE në mënyrë të vazhdueshme janë ndërmarrë fushata dhe iniciativa për sensibilizimin e klientëve për nevojën e përditësimit të këtyre të dhënave, (përfshirë këtu paraqitjen e kartës së ID, së atësisë, etj), për të evidentuar saktë të dhënat e klientit dhe të objektit që furnizohet me energji elektrike.

3. Për identifikimin e nuklit familjar, ky informacion rrjedh nga nevoja për grumbullimin e informacionit në sistemet e OSHEE-së dhe të shprehura në formularin bashkangjitur shkresës nr. 17225 prot. datë 17/09/2015, ku OSHEE i është drejtuar Komisionerit më shkresën “Kërkohe mendim”.

- Identifikimi i nuklit familjar rrjedh nga nevoja për arkëtimin e detyrimeve të papaguara.
- Identifikimi i nuklit familjar ndihmon në zhvillimin e një marrëdhënieje normale kontraktore, për të dyja palët. Posaçërisht për OSHEE, synon në arritjen e disa objektivave, duke krijuar një bazë të besueshme të të dhënave të klientëve të shoqërisë:
 - Marrjen e një sigurie të arsyeshme që llogaria e klientit ekziston.
 - Marrjen e një sigurie të arsyeshme mbi të ardhurat (faturimin), i cili realizohet kundrejt leximit të aparateve matës të energjisë .
 - Parashikim të besueshëm të kërkesës për energji elektrike (blerja).
 - Rritjen e normës së arkëtimeve.
 - Reduktimin e humbjeve kundrejt kapjes së konsumeve të klientëve aktuale.
 - Pastrimin e bazës së klientëve nga llogarite inekzistente.
 - Të qënurit kompetitive si aktivitet furnizimi të energjisë në kushtet e liberalizimit të tregut të furnizimit kundrejt krijimit të produkteve për konsumatorin në të ardhmen.

4. Nisur edhe nga rëndësia që mbart projekti në lidhje me qëllimin e ndërlidhjes së shërbimeve publike me shërbimin e territorit është përfshirë informacioni për përpunim për efekte statistikore të shërbimit publik të Ujësjellës Kanalizimeve dhe llojeve të shërbimeve që përfitojnë shtetasit, për të adresuar përgjegjësitë që rrjedhin nga Deklarata e Mileniumit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me furnizimin me Ujë duke e caktuar këtë të fundit si *një të drejtë universale* së bashku me detyrimet ligjore që rrjedhin për OSHEE.

5. Për identifikimin e pronës, informacion i rëndësishëm është lloji i banesës së shërbyer, pronësia dhe dokumentacioni i pronësisë, pasi ai na ndihmon që të kemi një informacion të besueshëm mbi: konsumet e energjisë një instrument të nevojshëm për përlllogaritjen e kërkesës për produktin përkatës që ofrohet, identifikimin e pronës në zonën e shërbimit me qëllim që të ndërlidhim sa më mirë shërbimin për klientin.

6. Lidhur me sigurinë, referuar specifikimeve teknike Termat e Referencës Ministrisë së Punëve të Brendshme (Aneksi nr.2), është parashikuar; i.2) "Siguria e platformës software"; i.3) Siguria e të dhënave personale;

Në lidhje me këto pretendime Zyra e Komisionerit sqaron se:

1-Në lidhje me pikën e parë, pretendimi se: "OSHEE i është drejtuar Komisionerit më Shkresën kërkohet mendim duke parashtruar nevojën e përditësimit dhe të dhënat që kërkohen duke bashkangjitur formularët përkatës. Komisioneri më shkresën 875/1 datë 08/10/2015 ka kthyer përgjigje duke kërkuar saktësimin e përdorimit të secilës nga rubrikat dhe qëllimi i grumbullimit të përputhet me qëllimin e përpunimit, ndërkaq sugjeron që në rast së ky informacion do të përdoret nga palë të treta shpërndarja të realizohet kundrejt akteve ligjore dhe/ose marrëveshjeve midis palëve", nuk qëndron, nga hetimi administrativ i ushtruar (sipas konstatimeve të mësipërme), është konstatuar se kontrolluesi OSHEE sh.a gjatë implementimit të projektit nuk ka zbatuar plotësisht detyrimet ligjore për të cilat është informuar paraprakisht nëpërmjet mendimit të Zyrës së Komisionerit.

2- Në lidhje me pikën e dytë, pretendimi se: "Nga ana e OSHEE në mënyrë të vazhdueshme janë ndërmarrë fushata dhe iniciativa për sensibilizimin e klientëve për nevojën e përditësimit të këtyre të dhënave", nuk qëndron, Zyra e Komisionerit ka dhënë mendim lidhur me implementimin e projektit paraprak të OSHEE-së duke i bërë me dije kontrolluesit të tregojë kujdes (referuar formularit të deklarimit të klientit) për informimin e plotë të klientit edhe në formularin e adresarit, për qëllimin dhe bazën ligjore mbi të cilën do të përpunoheshin të dhënat personale. Nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se formulari i adresarit nuk kishte të përfshirë plotësisht informimin në drejtim të qëllimit dhe mënyrës së përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë "Klientët", afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë.

3- Në lidhje me pikën e tretë, pretendimi se: "Për identifikimin e nuklit familjar, ky informacion rrjedh nga nevoja për grumbullimin e informacionit për popullimin e info (në tabelën këtu) në sistemet e infos të OSHEE-së dhe të shprehura në formularin bashkangjitur shkresës nr. 17225 prot datë 17/09/2015, ku OSHEE i është drejtuar Komisionerit më shkresën "Kërkohet mendim", nuk qëndron, Zyra e Komisionerit ka dhënë mendim lidhur me të dhënat që kërkohen në funksion të projektit duke e informuar kontrolluesin lidhur me qëllimin i cili duhej të përputhej me të gjithë kategoritë e të dhënave që synohen të mbledhen të cilat duhet të ishin të mjaftueshme, të lidheshin me qëllimin e përpunimit dhe të mos të tejkalonin atë.

4- Në lidhje me pikën e katërt, pretendimi se: "Nisur edhe nga rëndësia që mbart projekti në lidhje me qëllimin e ndërlidhjes së shërbimeve publike më shërbimin e territorit është përfshirë informacioni për përpunim për efekte statistikore të shërbimit publik të Ujësjellës Kanalizimeve dhe llojeve të shërbimeve që përfitojnë shtetasit, për të adresuar përgjegjësitë që rrjedhin nga Deklarata e Mileniumit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me furnizimin me Ujë duke e caktuar këtë të fundit si një të drejtë universale së bashku me detyrimet ligjore që rrjedhin për OSHEE", nuk qëndron, Zyra e Komisionerit vlerëson se mbledhja e të dhënave të kontratës me Ujësjellës Kanalizime nuk është as në kompetencë dhe as një detyrim ligjor i kontrolluesit OSHEE.

5- Në lidhje me pikën e pestë, pretendimi se: "Për identifikimin e pronës, informacion i rëndësishëm është lloji i banesës së shërbyer, pronësia dhe dokumentacioni i pronësisë, pasi ai na ndihmon që të kemi një informacion të besueshëm mbi konsumet e energjisë një

instrument të nevojshëm për përlogaritjen e kërkesës për produktin përkatës që ofrohet. identifikimin e pronës në zonën e shërbimit me qëllim që të ndërlihim sa më mirë shërbimin për klientin”, nuk qëndron, nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se kontrolluesi të dhënat për pronën i përpunon nëpërmjet fotografimit të çertifikatës së pronësisë e cila e tejkalon qëllimin për të pasur një informacion të besueshëm. certifikata e pronësisë përmban më shumë të dhëna nga sa është e nevojshme për një informacion të besueshëm me qëllim ofrimin e shërbimit ndaj klientit.

6- Në lidhje me pikën e gjashtë, pretendimi se: “Lidhur me sigurinë, referuar specifikimeve teknike *Termet e Referencës Ministrisë së Brendshme (Aneksi nr.2), është parashikuar: i.2) “Siguria e platformës software”; i.3) Siguria e të dhënave personale”*, nuk qëndron, në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, parashikohet se kontrolluesi duhet të ketë rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe jo e kulizuar vetëm në sigurinë e platformës *software* (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektesh të të dhënave).

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ, i cili ka qenë i ndërsjellët në funksion të zbatimit të ligjit. Në vijim kontrolluesi është angazhuar në përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 5/1/c, 18, 21, 22, 27, 29, 30, 31 pika 1/ “a/1” dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të marrë masa duke përfshirë në formularin e adresarit informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe bazën ligjore, mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë.
2. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet përditësimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.
3. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të hartohet një rregullore të brendshme mbi sigurinë e të dhënave personale, në të cilën të parashikohen masat konkrete organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e aksesit në të dhëna, të drejtat e subjekteve të të dhënave, afatet për mbajtjen e të dhënave, etj;
4. Kontrolluesi “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sha) të realizojë pezullimin e përpunimit të të dhënave personale për pronën (Foto e dokumentit të pronësisë) për klientët familjarë, të dhënat për nuklin familjar dhe të dhënat për shërbimet e Ujësjetës-Kanalizimeve, si të dhëna të mbledhura në tejkalim të qëllimit të përpunimit, sipas parashikimit të nenit 5/1/c të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

5. Kontrolluesi "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sha) të realizojë shkatërrimin e të dhënave personale, të evidentuara në pikën 4 të këtij Rekomandimi, të cilat janë mbledhur në tejkalim të qëllimit të përpunimit, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni.
6. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni.
7. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 12 / 5 2017.

